| Autoriteti Portual Durrës<br>DURRËS PORT AUTHORITY | MENAXHIMI<br>**POLITIKA E INTEGRUAR LIDHUR ME MENAXHIMIN E CILËSISË, MJEDISIT, ENERGJISË, SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË** | | |
|---|---|---|---|
| Kodi Nr.: PO.070 | Versioni: 1 | Data Efektive: 28.12.2020 | Faqe 1 / 1 |

**Autoriteti Portual Durrës (APD), si shoqëria që administron portin më të madh të Republikës së Shqipërisë, merr parasysh standardet më të larta të performancës lidhur me menaxhimin e Cilësisë, Mjedisit, Energjisë dhe Shëndetit e Sigurisë në Punë. Ne jemi të përkushtuar në sigurimin e një shërbimi cilësor për klientët tanë përmes një sistemi modern dhe efektiv menaxhimi, i cili integron çështjet e Cilësisë, Mjedisit, Energjisë dhe Shëndetit e Sigurisë në Punë. Ne jemi të vetëdijshëm se një sistem menaxhimi i tillë i mundëson stafit tonë të punojë në mënyrë më eficiente dhe më pak stresuese, në një mjedisi ku promovohet siguria, shëndeti dhe mirëqenia si dhe risqet vlerësohen e kontrollohen në mënyrë efektive.**

**Ne jemi të përkushtuar të nxisim te gjithë komunitetin portual të minimizojë ndikimet në mjedis, përmirësoje evidencën e konsumit energjetik përmes menaxhimit të koordinuar mjedisor, duke zvogëluar emetimet e $CO_2$ dhe duke ruajtur burimet natyrore e respektuar kështu edhe parimet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe përgjegjësisë shoqërore.**

**Angazhimi ynë:**

- Ruajmë sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e të gjithë punonjësve tanë dhe të të gjithë palëve të interesuara që mund të preken nga veprimet tona, si dhe sigurojmë një ambient pune të sigurtë dhe pa risqe për shëndetin ose mjedisin;
- Veprojmë në përputhje me legjislacionin që lidhet me sigurinë, shëndetin, mjedisin, energjinë dhe cilësinë, si dhe me rregulloret, kodet e praktikat më të mira të sektorëve respektivë;
- Implementojmë një Sistem Menaxhimi të Integruar (SIM) të Cilësisë, Mjedisit, Energjisë dhe Shëndetit e Sigurisë në Punë (CMESHSP / QEEHS) në pajtueshmëri me/dhe të certifikuar sipas ISO 9001, ISO14001, ISO 50001 dhe ISO 45001;
- Identifikojmë, vlerësojmë dhe kontrollojmë të gjithë risqet e lidhura me Cilësinë, Mjedisin, Energjinë dhe Shëndetin e Sigurinë në Punë, përmes planeve të përshtatshëm me qëllim eliminimin/zvogëlimin e ndikimeve që rrjedhin prej tyre;
- Vendosim dhe rishikojmë periodikisht objektivat dhe synimet për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të integruar të menaxhimit;
- Kryejmë Auditime të rregullta lidhur me Cilësinë, Mjedisin, Energjinë dhe Shëndetin e Sigurinë në Punë;
- Promovojmë dhe zhvillojmë një kulturë pozitive të cilësisë dhe sigurisë në organizatë. Komunikojmë me të gjithë punonjësit dhe gjithashtu zbatojmë së bashku këtë politikë si dhe objektivat e synimet e lidhura me të. Ofrojmë trajnime dhe mbështetjen e duhur dhe i nxisim të gjithë të marrin pjesë në përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së sistemit të integruar të menaxhimit;
- Promovojmë ndërgjegjësimin lidhur me Cilësinë, Mjedisin, Energjinë dhe Shëndetin e Sigurinë në Punë për kontraktorët, nënkontraktorët, furnitorët, klientët dhe palët tona të interesuara. Bëjmë transparente këtë politikë përmes faqes tonë të internetit si dhe promovimit në mjediset tona të punës. E komunikojmë atë për kontraktorët, furnitorët dhe klientët, për të rritur ndërgjegjësimin për Cilësinë, Mjedisin, Energjinë dhe Shëndetin e Sigurinë në Punë dhe për të inkurajuar zbatimin e praktikave të mira të punës në operacionet e tyre;
- Parandalojmë ndotjen, menaxhojmë emetimet, minimizojmë mbetjet, përdorim në mënyrë efiçente burimet dhe ndërgjegjësojmë për konservimin e tyre. Në mënyrë të vazhdueshme kërkojmë burime të ripërtëritshme dhe alternative të energjisë;
- Përfshijmë menaxhimin e qëndrueshëm të Cilësisë, Mjedisit, Energjisë dhe Shëndetit e Sigurisë në Punë në zhvillimet strategjike dhe planet e biznesit;
- Mbështesim prokurimin e produkteve dhe shërbimeve efiçiente të energjisë që impaktojnë performancën e energjisë dhe mbështesin aktivitetet dizenjuese që marrin në konsideratë përmirësimin e performancës së energjisë;
- Promovojmë integrimin e portit në qytet dhe inkurajomë integrimin e tij në strukturën shoqërore të qytetit;
- Sigurojmë burimet e nevojshme për implementimin e kësaj Politike.

| **PUNOI:** Bukurie Qunaj | **PRANOI:** | **MIRATOI:** Pirro Vengu |
|---|---|---|
| Nënshkrimi:<br>Data: 23/12/2020 | Nënshkrimi: Florian Mesh[illegible]<br>Data: | Nënshkrimi:<br>Data: 24/12/2020 |

| Autoriteti Portual Durrës DURRES PORT AUTHORITY | MENAXHIMI<br>**POLITIKA E INTEGRUAR LIDHUR ME MENAXHIMIN E CILËSISË, MJEDISIT, ENERGJISË, SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË** | | |
|---|---|---|---|
| Kodi Nr.: PO.070 | Versioni: 1 | Data Efektive: 28.12.2020 | Faqe 1 / 1 |

**Autoriteti Portual Durrës (APD), si shoqëria që administron portin më të madh të Republikës së Shqipërisë, merr parasysh standardet më të larta të performancës lidhur me menaxhimin e Cilësisë, Mjedisit, Energjisë dhe Shëndetit e Sigurisë në Punë. Ne jemi të përkushtuar në sigurimin e një shërbimi cilësor për klientët tanë përmes një sistemi modern dhe efektiv menaxhimi, i cili integron çështjet e Cilësisë, Mjedisit, Energjisë dhe Shëndetit e Sigurisë në Punë. Ne jemi të vetëdijshëm se një sistem menaxhimi i tillë i mundëson stafit tonë të punojë në mënyrë më eficiente dhe më pak stresuese, në një mjedisi ku promovohet siguria, shëndeti dhe mirëqenia si dhe risqet vlerësohen e kontrollohen në mënyrë efektive.**
**Ne jemi të përkushtuar të nxisim te gjithë komunitetin portual të minimizojë ndikimet në mjedis, përmirësoje evidencën e konsumit energjetik përmes menaxhimit të koordinuar mjedisor, duke zvogëluar emetimet e $CO_2$ dhe duke ruajtur burimet natyrore e respektuar kështu edhe parimet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe përgjegjësisë shoqërore.**

**Angazhimi ynë:**

• Ruajmë sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e të gjithë punonjësve tanë dhe të të gjithë palëve të interesuara që mund të preken nga veprimet tona, si dhe sigurojmë një ambient pune të sigurtë dhe pa risqe për shëndetin ose mjedisin;
• Veprojmë në përputhje me legjislacionin që lidhet me sigurinë, shëndetin, mjedisin, energjinë dhe cilësinë, si dhe me rregulloret, kodet e praktikat më të mira të sektorëve respektivë;
• Implementojmë një Sistem Menaxhimi të Integruar (SIM) të Cilësisë, Mjedisit, Energjisë dhe Shëndetit e Sigurisë në Punë (CMESHSP / QEEHS) në pajtueshmëri me/dhe të certifikuar sipas ISO 9001, ISO14001, ISO 50001 dhe ISO 45001;
• Identifikojmë, vlerësojmë dhe kontrollojmë të gjithë risqet e lidhura me Cilësinë, Mjedisin, Energjinë dhe Shëndetin e Sigurinë në Punë, përmes planeve të përshtatshëm me qëllim eliminimin/zvogëlimin e ndikimeve që rrjedhin prej tyre;
• Vendosim dhe rishikojmë periodikisht objektivat dhe synimet për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të integruar të menaxhimit;
• Kryejmë Auditime të rregullta lidhur me Cilësinë, Mjedisin, Energjinë dhe Shëndetin e Sigurinë në Punë;
• Promovojmë dhe zhvillojmë një kulturë pozitive të cilësisë dhe sigurisë në organizatë. Komunikojmë me të gjithë punonjësit dhe gjithashtu zbatojmë së bashku këtë politikë si dhe objektivat e synimet e lidhura me të. Ofrojmë trajnime dhe mbështetjen e duhur dhe i nxisim të gjithë të marrin pjesë në përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së sistemit të integruar të menaxhimit;
• Promovojmë ndërgjegjësimin lidhur me Cilësinë, Mjedisin, Energjinë dhe Shëndetin e Sigurinë në Punë për kontraktorët, nënkontraktorët, furnitorët, klientët dhe palët tona të interesuara. Bëjmë transparente këtë politikë përmes faqes tonë të internetit si dhe promovimit në mjediset tona të punës. E komunikojmë atë për kontraktorët, furnitorët dhe klientët, për të rritur ndërgjegjësimin për Cilësinë, Mjedisin, Energjinë dhe Shëndetin e Sigurinë në Punë dhe për të inkurajuar zbatimin e praktikave të mira të punës në operacionet e tyre;
• Parandalojmë ndotjen, menaxhojmë emetimet, minimizojmë mbetjet, përdorim në mënyrë efiçente burimet dhe ndërgjegjësojmë për konservimin e tyre. Në mënyrë të vazhdueshme kërkojmë burime të ripërtëritshme dhe alternative të energjisë;
• Përfshijmë menaxhimin e qëndrueshëm të Cilësisë, Mjedisit, Energjisë dhe Shëndetit e Sigurisë në Punë në zhvillimet strategjike dhe planet e biznesit;
• Mbështesim prokurimin e produkteve dhe shërbimeve efiçiente të energjisë që impaktojnë performancën e energjisë dhe mbështesin aktivitetet dizenjuese që marrin në konsideratë përmirësimin e performancës së energjisë;
• Promovojmë integrimin e portit në qytet dhe inkurajomë integrimin e tij në strukturën shoqërore të qytetit;
• Sigurojmë burimet e nevojshme për implementimin e kësaj Politike.

| **PUNOI:** Bukurie Ozuni | **PRANOI:** | **MIRATOI:** Pirro Vengu |
|---|---|---|
| Nënshkrimi: | Nënshkrimi: | Nënshkrimi: |
| Data: 23/12/2020 | Data: Florian Mykhteta | Data: 24/12/2020 |